



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

DREJTIMI MËSIMOR “BUJQËSI”

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Bujqësi**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Bujqësi”, Niveli I; në profilin “Ferma bujqësore e blegtorale”, Niveli II, “Frutikulturë”, Niveli II, “Rritje e kafshëve dhe shpendëve”, Niveli II, “Mekanikë bujqësore”, Niveli II dhe profilin “Kopshtari”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Bujqësi”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr. 61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë testime të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Bujqësi**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë.

Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “Bujqësi”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Bazat e bujqësisë, kl. 10.
2. Perime e lule, kl. 10.
3. Mekanikë bujqësore, kl.10 dhe kl. 11.
4. Bimë arash, kl. 11.
5. Pemë frutore, kl. 11.
6. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12.
7. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.
8. Kontabilitet dhe ligjshmëri bujqësore, kl. 13.
9. Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave, kl. 13.
10. Bazat e bujqësisë organike, kl. 13.
11. Drejtim fermash bujqësore, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e bujqësisë	28	10
2	Perime e lule	30	11
3	Mekanikë bujqësore	26	10
4	Bimë arash	43	15
5	Pemë frutore	43	15
6	Bazat e sipërmarrjes	19	7
7	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
8	Kontabilitet dhe ligjshmëri bujqësore	17	6

9	Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave	15	5
10	Bazat e bujqësisë organike	34	12
11	Drejtim fermash bujqësore	10	4
	TOTALI	279	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a. **“Bazat e bujqësisë”, kl. 10: (28 orë)**
- Bimët dhe mjedisi. 8 orë
 - Morfologjia dhe fiziologjia e bimëve. 8 orë
 - Toka bujqësore. 12 orë
 - Agroteknologjia e kulturave bujqësore. 8 orë
- b. **Perime e lule, kl. 10: (30 orë)**
- Perimet e familjes solanore. 12 orë
 - Perimet e famijes bostanore. 12 orë
 - Perimet e familjes bishtajore. 6 orë
- c. **Mekanikë bujqësore, kl.10 dhe kl. 11: (26 orë)**
- Makinat për punimin bazë të tokës. 6 orë
 - Makinat për punimin sipërfaqësor të tokës. 6 orë
 - Makinat mbjellëse. 6 orë
 - Makinat për korrje -shirje-vjelje dhe përpunimit të drithit. 8 orë
- d. **Bimë arash, kl.11: (43 orë)**
- Drithërat. 18 orë
 - Patatja. 5 orë
 - Bimët foragjere, hasëllet dhe tagjitë. 12 orë
 - Livadhet dhe kullotat. 8 orë
- e. **Pemë frutore, kl.11: (43 orë)**
- Shtimi i pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve. 19 orë
 - Agroteknika e pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve. 18 orë
 - Njohuri të përgjithshme për vreshtarinë. 6 orë
- f. **Bazat e sipërmarrjes, kl. 12: (19 orë)**
- Menaxhimi i informacionit. 4 orë
 - Menaxhimi i marketingut 5 orë
 - Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
 - Legjislacioni i punës 5 orë

g.	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13:	(14 orë)
	• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
	• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
	• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
	• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë
g.	Kontabilitet dhe ligjshmëri bujqësore, kl.13:	(17 orë)
	• Tatimi mbi vlerën e shtuar	4 orë
	• Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë	2 orë
	• Bashkëpronësia dhe shpronësimi	2 orë
	• Uzurfrukti dhe servituti	2 orë
	• Kontratat llojet e kontratave	2 orë
	• Qeraja e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave	2 orë
	• Kuptimi, rëndësia, shfrytëzimi i pyjeve, fondi pyjor si dhe regjimi juridik i ujërave.	3 orë
h.	Përmirësimi ujqor dhe sistemimi i tokave, kl.13:	(15 orë)
	• Mënyrat e ujitjes.	5 orë
	• Rrjetet kulluese dhe drenazhimi.	5 orë
	• Sistemimi sipërfaqësor kurriz dhe rrafsh i tokave bujqësore.	5 orë
i.	Bazat e bujqësisë organike, kl.13:	(34 orë)
	• Kuptimi, rëndësia dhe përparësitë e bujqësisë organike	4 orë
	• Burimet natyrore dhe administrimi i tyre.	10 orë
	• Agroteknologjia e prodhimit organik.	10 orë
	• Larmia biologjike.	3 orë
	• Mbarështrimi organik i kafshëve. Akuakultura organike.	7 orë
j.	Drejtimit fermash bujqësore, kl.13:	(10 orë)
	• Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi.	3 orë
	• Sigurimi dhe përdorimi i tokës.	2 orë
	• Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës.	2 orë
	• Madhësia e fermës dhe rritja e saj.	3 orë